



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 19602/ Prot.

Tiranë, më 07.07.2022

V E N D I M

Nr. 22 datë. 07.07.2022

**“PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË Z. EUGEN NASUFI NË VENDIN VAKANT PËR
INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË MË DATË 30.09.2021”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho – Kryetar
Znj. Joana Asimi – Anëtar
Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili
Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 07.07.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Z. Eugen Nasufi

OBJEKTI: Urdhërimi i lejimit të kandidimit të Z. Eugen Nasufi, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".
4. Z. Eugen Nasufi, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 3982 prot., datë 28.10.2021 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit

nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 16.11.2021, kandidati Eugen Nasufi, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit i Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 18.11.2021, kandidati Eugen Nasufi ka depozituar pranë sekretariatit teknik formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën nr. 4228 prot., datë 26.11.2021, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Me shkresën nr. 4228 prot., datë 26.11.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka dërguar ILDKPKI listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e

konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë", i ndryshuar.

9. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI -së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Eugen Nasufi, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
10. Me shkresën nr. 4570/1 prot, datë 24.12.2021, ILDKPKI ka informuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së kandidati Eugen Nasufi, e ka përmbushur detyrimin për të dorëzuar të plotësuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të Kandidatit për pozicione të ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
11. ILDKPKI. në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 667/24 prot, datë 07.02.2022, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin Eugen Nasufi dhe personat e lidhur me të.
12. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ky institucion kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Eugen Nasufi dhe personave të lidhur me të si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimi të kriterit të pasurisë.
13. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Eugen Nasufi, referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezultojnë se ILDKPKI me shkresën nr. 667 prot, datë 15.12.2021 i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin z. Eugen Nasufi institucioneve: *Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen sha, Banka Kombëtare Tregtare sha, Banka Intesa Sanpaolo sha, Banka Alpha Albania sha, Banka Tirana sha, Banka e Bashkuar e Shqipërisë sha, Banka Procredit sha, Banka e Parë e Investimeve sha, Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka Credins sha, Banka Union sha, Banka OTP Albania sha, Raiffeisen Leasing sha, Porsche Leasing sha,*

RFZ Invest sha, Credins Invest sha, DPSHTRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.

14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjorë, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", kandidati Eugen Nasufi ka depozituar diplomën nr. 4193 datë 25.06.1996 të arsimit të lartë lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave". Gjithashtu, kandidati Eugen Nasufi ka depozituar edhe diplomën nr. 0351, datë 15.07.2012 Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Juridike me profil E Drejtë Biznesi, lëshuar nga Universitetit "Marin Barleti".
15. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, që lidhen me kontrollin e integritetit të kandidatit Eugen Nasufi, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "b", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 4268 prot, datë 02.12.2021*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 4263 prot, datë 02.12.2021*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 4265 prot, datë 02.12.2021*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.4269 prot, datë 02.12.2021*).
16. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht (*me shkresën nr.28 prot., datë 06.01.2022, shkresën nr.6711 /17 prot., datë 16.12.2021, shkresën nr. 4620/2 prot., date 28.12.2021 dhe shkresën nr.1157 prot., datë 10.12.2021*).
17. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 4264 prot., datë 02.12.2021 është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. 4260 prot., datë 02.12.2021 Prokurorisë të Përgjithshme dhe me shkresën nr. 4261 prot., datë 02.12.2021 Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me:

- Çdo të dhënë apo indicie të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptim të ligjit material dhe procedural mbi të cilin ushtron veprimtarinë ky institucion kushtetues;
- Kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të kandidatit jomagjistratë në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;
- Nëse janë zhvilluar ndaj tyre procese gjyqësore të karakterit penal, dhe rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore.

18. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 9874/1 prot., datë 14.12.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021 të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve dhe shkresën nr. 1689/14 prot., datë 13.12.2021 të Prokurorisë të Përgjithshme.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit në ILD, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 4259 prot, datë 02.12.2021 dhe me shkresën nr. 214 prot, datë 27.01.2022, në lidhje me periudhën e derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7674/1 prot, datë 13.12.2021, shkresën nr. 12854/1 prot, datë 16.12.2021 dhe me shkresën nr. 1108/1 prot, datë 10.02.2022.

20. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, u vlerësua ti drejtohem i kërkesë për informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë me nr. 4266 prot., datë 02.12.2021. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të Vendimit Nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. 333 prot., datë 22.12.2021 (informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit).

21. Gjithashtu, lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209 pika 6, germa "d" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është dërguar shkresë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (*shkresa nr. 4261 prot., datë 02.12.2021*), ku është kërkuar informacion nëse kandidati është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit*", i është kërkuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish - Sigurimit të Shtetit nëse secili kandidat, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "*e) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991*" apo në njërin nga rastet më të përgjithshme të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë."

Me shkresën nr. 4262 prot, datë 02.12.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1886/4 prot, datë 20.01.2022 ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili i është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (*Vendimi nr.16, datë 17.01.2022* i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).

24. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhen me integritetin e kandidatëve për inspektorë jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, germa "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, është njoftuar zyrtarisht secili kandidat që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:

- mospasjen e funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;

- mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Për sa i takon kandidatit Eugen Nasufi, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

25. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 " *Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave " *Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit*", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, " *Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*, është vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
26. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 " *Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave " *Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit*", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, " *Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*, Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 06.07.2022, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të z. Eugen Nasufi , për vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

27. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit Eugen Nasufi për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

28. Në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen "Kushtet për inspektor jomagjistrat", prej nga rezulton se:

Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;
- b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;
- ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
- ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

29. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana ILDKPKI-së, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 667/24 prot, datë 07.02.2022, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Eugen Nasufi dhe personat e lidhur me të.

30. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Eugen Nasufi ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarin të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

31. Pra, mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Eugen Nasufi.
32. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit*", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "*Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*", Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Eugen Nasufi ka "*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij*". Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.
33. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të "*a) të jetë shtetas shqiptar me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;*" nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Eugen Nasufi ka depozituar diplomë nr. 4193 datë 25.06.1996 të arsimit të lartë lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave". Gjithashtu, kandidati Eugen Nasufi ka depozituar edhe diplomën nr. 0351, datë 15.07.2012 Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Juridike me profil E Drejtë Biznesi, lëshuar nga Universitetit Marin Barleti. Për rrjedhojë kandidati Eugen Nasufi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.
34. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "b" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati "*b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale*", nga aktet e administruara në dokumentacionin e aplikimit si dhe bazuar në rezultatet e arritura nga kandidati në shkollë të lartë ku ka fituar titullin "Jurist", kandidati Eugen Nasufi e plotëson këtë kriter.

35. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "b" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati "*b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale*", kandidati Eugen Nasufi ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*", të cilin, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
36. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, me shkresën me nr. 4264 prot., datë 02.12.2021 është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Me shkresën me nr. 9874/1 prot., datë 14.12.2021, kjo Prokurori ka dërguar informacionin se për z. Eugen Nasufi, kandidat për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
37. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1689/14 prot., datë 13.12.2021 ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Eugen Nasufi, duke i bashkëngjitur vendimin e datës 10.12.2021. Në bazë të pikës 4.2.2 të vendimit të sipërcituar, parashikohet se: *indiciet, të dhënat apo faktet që i atribuohen personit/subjektit të ligjit për dënimet penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar apo dëbime nga territori i një shteti, janë të domosdoshme ligjërish, pasi vetëm mbi bazë të tyre mund t'i kërkohet autoriteteve të huaj policore dhe gjyqësore, informacion dhe dokumenta, nga të cilat mund të parqitën rrethana që përfshihen brenda ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 138/2015*. Për këtë shkak, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur mospranimin e kërkesës së ILD-së, për verifikim të të dhënave të pasqyruara në Formularin e Vetëdeklarimit të datës 18.11.2021 personi/subjekti Eugen Nasufi kandidat për pozicionin e inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
38. Referuar nenit 209, pika 6, germës "b" të ligjit nr. 115/2016, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Eugen Nasufi, krahas plotësimit të saktë formularit të vetëdeklarimit, nuk u vu në dijeni të ndonjë indicieje, të dhëne apo fakteve që i atribuohen këtij kandidati për dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar apo dëbime nga territori i një shteti. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
39. Gjithashtu, për të verifikuar çdo të dhënë tjetër që lidhet me integritetin, bazuar në nenin 209, pika 6, germa "b" e ligjit nr. 115/2016, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimi të Inspektorëve verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organet kompetente ligjzbatuese si

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati *"ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar"*.

Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretime të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

40. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.4620/2 prot., date 28.12.2021, ka përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin e kërkuar, të cituar më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eugen Nasufi:

"a) Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale, apo të kenë lidhje kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë me krimin e organizuar në ngarkim të z. Eugen Nasufi".

41. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.28 prot., datë 06.01.2022, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eugen Nasufi:

"a) Nuk disponon të dhëna informacione për përfshirjen në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme dhe që bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 38 të ligjit nr.84, të vitit 2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe pikën 66, gjerat a) dhe c) të VKM nr. 536, datë 25.07.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotë të kushteve dhe kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë të kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit në ngarkim të z. Eugen Nasufi."

42. Shërbimi Informativ i Shtetit, me shkresën nr.6711/17 prot., datë 16.12.2021, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga

agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eugen Nasufi.

“a) Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme në ngarkim të z. Eugen Nasufi.”

43. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me shkresën nr.1157 prot., datë 10.12.2021, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eugen Nasufi:

“a) Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme në ngarkim të z. Eugen Nasufi.”

44. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa “b” të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

45. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin e kushteve që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si “Jurist”, jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 4259 prot, datë 02.12.2021 dhe me shkresën nr. 214 prot, datë 27.01.2022, në lidhje me periudhën e derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7674/1 prot, datë 13.12.2021, shkresën nr. 12854/1 prot, datë 16.12.2021 dhe me shkresën nr. 1108/1 prot, datë 10.02.2022.

46. Në përgjigje të informacionit të kërkuara për sa më sipër, Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 7674/1 prot, datë 13.12.2021, shkresën nr. 12854/1 prot, datë 16.12.2021 dhe me shkresën nr. 1108/1 prot, datë 10.02.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar faktin se në këtë institucion shtetëror gjenden të administruara kontributet të cilat mblidhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet WebService, të dhënat të cilat i disponojnë nga viti 2012 deri në muajin sipas formularit bashkëlidhur të dërguar pranë ILD-së.

47. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *“c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet”*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë diplomën/kualifikimet,

jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Eugen Nasufi ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- Jurist, Këshilli i Rrethit Dibër, 16 Shtator 1996-20 Mars 1998;
- Jurist, pranë Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër për periudhën 20 Mars 1998-31 Dhjetor 2001;
- Oficer aktiv, Jurist, Shërbimi Informativ Shtetëror për periudhën 05 prill 2005- 01 Nëntor 2005;
- Konsulent ligjor, Shoqata Aksion Plus për periudhën 01 Qershor 2003-04 Prill 2005;
- Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë për periudhën 01 Nëntor 2005-18 Shtator 2011;
- Përgjegjës i Sektorit të Personelit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Qytetit Tiranë, për periudhën 23 Shtator 2011- 31 Dhjetor 2011;
- Drejtor Drejtorie Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Qytetit Tiranë për periudhën 01 Janar 2012- 17 Gusht 2015;
- Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për periudhën 01 Dhjetor 2015-21 Gusht 2020;
- Ndhmës Inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 21 Gusht 2020- deri në datën e paraqitjes së aplikimit.

48. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Komiteti konstaton se kandidati Eugen Nasufi ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga neni 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

49. Për sa i përket urdhërimeve të nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të Vendimit Nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", ku kërkohet që kandidati për inspektor jomagjistrat, të mos ketë ushtruar në mënyre aktive, profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit është kthyer përgjigje nga Dhoma Kombëtare të Avokatisë me shkresën 333 prot., datë 22.12.2021. Në bazë të kësaj përgjigjeje rezulton se "Eugen Nasufi, ka fituar titullin avokat dhe është mbajtës i licencës me nr. 3246, në vitin 2007. Nuk ka ushtruar profesionin e avokatit për shkak të papajtueshmërisë ligjore, parashikuar nga neni 7 i ligjit nr.55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë". Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

50. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "d", "dh", "e", "ë" dhe "f", të ligjit nr. 115/2016, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Eugen Nasufi, në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe atë të mbërritur nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
51. Në nenin 209, pika 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "*d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi*". Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë certifikatën e gjendjes gjyqësore, që është administruar në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati Eugen Nasufi, nuk rezulton të jetë dënuar. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
52. Gjithashtu, lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209, pika 6, germa "d" e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021, jep informacionin se për shtetasin Eugen Nasufi "*Rezulton se nuk ka shënime në sistem, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë*".
53. Në nenin 209, pika 6, germa "dh" e ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët dh) "*të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit*". Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati Eugen Nasufi, nuk rezulton të ketë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
54. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit në bazë të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", kandidati Eugen Nasufi ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit "*Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta*" parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
55. Bazuar në përgjigjen nr.1886/4, datë 20.01.2022 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, është administruar vendimi nr.16, datë 17.01.2022, nga ku rezulton se kandidati Eugen Nasufi, nuk ka qenë *person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991*" apo në njërin nga rastet më të përgjithshme të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015

"Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e" të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

56. Në nenin 209, pika 6, germa "e" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët *"ë) të deklarojnë se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit;"*

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati Eugen Nasufi, nuk rezulton të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë, kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

57. Në nenin 209, pika 6, germa "f" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët *"f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit."*

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati Eugen Nasufi, nuk rezulton të jetë anëtarë e organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

58. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Eugen Nasufi, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021, pasi kandidati plotëson të gjitha kriteret parashikuara në nenin 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit"*.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për

verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

V E N D O S I:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Eugen Nasufi, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Eugen Nasufi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR


Julian Zonja

KRYETAR


Besnik Maho

ANËTAR


Joana Asimi

